

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit **S.B nga ...**, per shkak te vepres penale vjedhje e sherbimeve komunale nga neni 320 te KP-es, sipas aktakuzes së Prokurorise Themelore në Prizren PP.nr.1621/2016 të datës 29.09.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare publike, në prezencën e Prokurorit Themelore në Prizren Beqe Shala, të akuzuarit, me datë **05.10.2017**, mori dhe shpalli publikisht këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari **S.B**, nga i ati G..., e ëma Z..., e vajzërisë ..., i lindur më datë ... në fsh. ..., tani me banim ne ... rr. "...”pn, ka të kryer shkollën e lartë të maqineris, i pa pune, i martuar baba i 3 femijeve, i gjendjes se dobet ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se prej dates se pavertetuar e deri me dt.02.03.2016, ne shtepin e tij i akuzuari, me qellim te perfitimit te kunderligjshem per vete, e shfrytezon energjine elektrike ne menyre direkte me nje kabell jashte njehsorit elektrik, ashtu qe energjia e shpenzuar elektrike nuk eshte regjistruar, me ç’ka te demtuares Keds – Kompania Kosovare per Distribuim dhe Furnizim me energji Elektrike sh.a Distrikti Prizren, i ka shkaktuar dem ne vlere prej 416.16 euro.

- kesodore ka kryer vepren penale vjedhje e sherbimeve komunale nga neni 320 te KP-es,

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 42, 43, 46, 49 par.1 p.1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75 e 76 te KPK-se, dhe neni 365 te KPPK-es te akuzuarit i shqipton:

DENIM ME GJOBË

Ne lartesi prej **150 /njqindepesedhjete/ Euro** te cilen shume te denimit i akuzuari eshte i obliguar te paguaj ne afat prej 15 diteve, pas plotefuqishmerise te ketij aktgjykimi, i akuzuari denimin me gjobe do te paguaj ne 3 kiste dhe ate duke filluar per çdo fillim te muajit nga dt.01. e deri me dt.05. nese denimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim i njeiti do te zevendesohet me denim burgu duke llogaritur per çdo 20 Euro nje dite burg.

DENIM ME KUSHT

Ashtu që i verteton denimin me burgim në kohezgjatje prej **3 muajve** i cili denim nuk do të ekzekutohet në afatin prej **1 viti** nga dita e plotëfuqishmeris së këtij aktvendimi, nëse i akuzuari nuk do të kryen ndonjë veprë të re penale.

I akuzuari në kuptim të nenit 454 të KPPK lirohet nga shpenzimet e procedurës penale si dhe ato të paushallit gjyqësor.

Perfaqësoesi i autorizuar i të demtuarës Keds – distrikti në Prizren, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën me PP.nr.3568/2015 të dt.14.03.2016, kundër të akuzuarit N.P nga fsh. ... KK ..., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-es.

Gjykata në shqyrtim kryesore ka vërtetuar gjendjen e këtyre faktike nga pranimi i fajësive nga ana e të akuzuarit i cili vullnetarisht e ka pranuar fajësin, për shkak të së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vëhet në bërë, e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzime, duke u mbështetur në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykat ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësive nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-së, dhe faktet që përmban aktakuzën, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale, vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së, dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me kusht si të merituar, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tijë penalo-juridike.

Me rastin e caktimit të denimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KP-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht rëndëse, e si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësive nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë i tijë, në kuptim të nenit 74, 75, e 76 gjykata morri për bazë edhe faktin se i akuzuari ka bashkëpunuar me gjykatën, bashkëpunimi i tijë ka qenë vullnetar në hetimin dhe ndjekjen penale, gjer me tani i pa gjykuar, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, i pa punë, i gjendjes së varfer ekonomike, mbajtes i familjes 6 anetareshë, andaj gjykata iu shqiptoi denimin me gjorë e me kusht sepse konsideron se me këto mase sanksionuese do të arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tijë dhe me këto denim do të arrihet qellimi i denimit që në të ardhmen të jetë i kujdesshem dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 454 të KPPK-së.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

P.nr. 561/2016 të datës 23.12.2016

**Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari**

**Gjyqtari
Fatmir Krasniqi**

UDHËZIM JURIDIK: Kunder ketij aktgykimi pala e pakenaqr ka te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.